

KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “FEK 06” SHPK

Sot, më 15.01.2025, lidhet kjo kontratë për shitjen e kuotave të Shoqërisë “FEK 06” Sh.p.k. (në vijim të referuar si “**Kontrata**”), midis Palëve të mëposhtme:

- Flamur Nuhaj, i biri i Shefit-it, lindur më 22.12.1968 në Fier, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, banues në adresën: Usojë, Ballsh, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal G81227010D, (në vijim të referuar si “**Shitësi**”);

Dhe

- Florjan Nuhaj, i biri i Flamur-it, lindur më 21.11.1994 në Ballsh, Mallakastër, me kombësi shqiptare, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, banues në adresën : Ballsh, Mallakastër mbajtës i pasaportës me nr. Personal J41121022P, (në vijim referuar si “**Blerësi**”).

Shitësi dhe Blerësi në vijim do të referohen bashkërisht si “**Palët**”.

DUKE PASUR PARASYSH QË:

- Shoqëria “FEK 06” Sh.p.k. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT: K67917806I, me seli në Ballsh, në adresën: Lagja 5 Shkurti, e përfaqësuar nga Administratori z. Florjan Nuhaj, 100% e kuotës të së cilës zotërohet nga ortaku i vetëm, z. Flamur Nuhaj.
- Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, Flamur Nuhaj, synon të shesë kuotën e tij, që përbën 100% të kuotave të shoqërisë;
- Z. Florjan Nuhaj ka shprehur gadishmërinë për të blerë kuotën e zotëruar nga Ortaku i Vetëm.

Për sa më sipër, Palët bien dakord si vijon:

Neni 1

Objekti

- 1.1 Objekti i kësaj Kontrate është kalimi e kuotës së Shoqërisë, si më poshtë:
 - Ortaku i Vetëm z. Flamur Nuhaj i shet z. Florjan Nuhaj kuotën e tij në Shoqëri që përbën 100% të kuotave të shoqërisë.
- 1.2 Me nënshkrimin e Kontratës, Blerësit i kalojnë 100 % e kuotës së shitësit dhe në këtë mënyrë Blerësi bëhet Ortaku i Vetëm në Shoqëri.

Neni 2

Çmimi



- 2.1 Çmimi i shitjes së kuotës së Shoqërisë "FEK 06" shpk, është e barabartë me 100.000 (njëqindmijë) Lekë, korresponente me 100% të kuotës së kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 3

Garancitë

- 3.1 Shitësi deklaron se është i vetmi titullar i ligjshëm i kuotave që po transferohen nëpërmjet kësaj Kontrate, dhe se ato janë të lira nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e Palëve

- 4.1 Shitësi deklaron se, me nënshkrimin e kësaj kontrate, i kalon Blerësit gjithsej 100 % të kuotës së vetme të Shoqërisë në pronësi të tij, së bashku me të gjitha drejtat e tjera të lidhura me to.
- 4.2 Blerësi fiton pronësinë mbi 100 % të kuotave të Shoqërisë me të drejta të plota.

Neni 5

Të ndryshme


- 5.1 Pas kalimit të kuotave me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Florjan Nuhaj bëhet zotëruar i ligjshëm sipas legjislacionit shqiptar, i kuotës së vetme të shoqërisë, në masën 100% të kuotave të Shoqërisë, ndërsa Shitësi Flamur Nuhaj zhvishet nga pronësia dhe çdo e drejtë mbi 100 % të kuotave të Shoqërisë.
- 5.2 Kjo Kontratë është hartuar në përputhje me dispozitat e legjislacionit tregtar shqiptar dhe për çështje, të cilat nuk janë rregulluar posaçërisht në këtë Kontratë, Palët do t'i referohen legjislacionit shqiptar në tërësi.
- 5.3 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis Palëve në lidhje me këtë kontratë do të zgjidhen me mirëkuptim midis Palëve. Në rast të kundërt, organi kompetent për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.
- 5.4 Kontrata nënshkruhet nga Palët, sot, në 3 (tri) kopje origjinale në shqip.

Emrat dhe Nënshkrimet:

SHITËSI:


Flamur NUHAJ
BALLSH
MALLAKASTER AIBANA

BLERËSI:


Florjan NUHAJ